



Nr.7

ISSN 2521-831X

BULETINI MUJOR KLIMATIK

Korrik 2017



Universiteti Politeknik i Tiranës

Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit & Mjedisit

Tirana © 2017



BULETINI MUJOR KLIMATIK

KORRIK2017
Nr. 7

Vlerësimi meteorologjik për muajin korrik 2017

Përmbledhje: Muaji korrik 2017 u karakterizua nga prania e masave ajrore që përcollën temperatura të ajrit më të larta se norma me rreth $+2^{\circ}\text{C} \div +3^{\circ}\text{C}$, ndërkohë që u shënuan dhe rritje e numrit të netëve tropikale. Gjithashtu u vërtetuan reshje atmosferike përgjithësisht me vlera nën normë.


Summary: The month of July 2017 has been characterized by the presence of air mass that provided high air temperatures about $+2^{\circ}\text{C} \div +3^{\circ}\text{C}$ compare to the norm values. In mean time it has been observed an increased number of tropical nights. Also the atmospheric precipitation observed has been under the norm values.

Muaji korrik 2017 u karakterizua nga mbizotërimi i masave ajrore të qëndrueshme e me presion të lartë atmosferik me origjinë kryesisht nga pjesa veriore e kontinentit Afrikan, duke përcjellë në pjesën më të madhe të kohës mot pa reshje dhe me temperatura mjaft të larta (figura Nr.1). Ashtu siç është vërtetuar dhe në vitet e fundit numri i **netëve tropikale** me temperaturë gjatë natës mbi pragu 20.0°C shënoi rritje kundrejt vlerave të normës. Reshjet e vërtetuara prekën kryesisht zonën kodrinore e malore, ndërsa pothuajse nuk u vërtetuan në të gjithë pjesën tjetër të vendit.

Figura Nr. 1. Situata sinoptike e datës 11 korrik 2017.

Në vijim në figurat Nr.2/1÷2/12, jepen grafikisht të dhënat për vlerat ditore të temperaturave maksimale dhe minimale të ajrit si dhe reshjeve ditore për disa vendmatje meteorologjike të përzgjedhura nga mbarë vendi. Në këto grafikë dallohet qartë jo vetëm situata e reshjeve, por dhe ruajtja e një niveli të lartë në veçanti e temperaturave maksimale të ajrit për mjaft ditë gjatë këtij muaji mbi pragu $+35.0^{\circ}\text{C}$.

Një nivel i tillë i temperaturave të ajrit dhe për më tepër mungesa e reshjeve, ndikuan në theksimin e dukurisë së thatësisë dhe kohëzgjatjes së saj, si dhe në tërësi krijuan kushte favorizuese për zjarret në pyje, të cilat gjatë këtij muaji ishin mjaft evidente në tërë vendin.



The figure displays 12 meteorological charts arranged in a 6x2 grid, showing the monthly climate data for various locations in Albania for the month of March 2017. Each chart plots Temperature (°C) on the left y-axis (0 to 40) and Reshje (mm) on the right y-axis (0 to 30) against the day of the month (DATA 1 to 31). The charts include three data series: Reshje (mm) represented by blue bars, T. minimale (°C) represented by a green line, and T. maksimale (°C) represented by an orange line. The locations are: Bogë, Shishtavec, Koplik, Shupenzë, Krujë, Fshati Klos, Tiranë, Petresh, Fier, Bilisht, Konispol, and Dushar.

KARAKTERISTIKAT KRYESORE KLIMATIKE TË MUAJIT: KORRIK 2017

Nga pikëpamja klimatike muaji korrik në Shqipëri në mbarë vendin shënon periudhën me temperatura të ajrit më të larta ndër gjithë muajt e tjerë të vitit. Gjithashtu ai karakterizohet dhe me sasinë më të vogël të reshjeve. Nga ana tjetër duhet thënë se sipas matjeve apo përlogaritjeve me metodika të ndryshme shkencore, muaji korrik shënon muajin kur vlerat e avullimit arrijnë nivelet më të larta deri në afro 5÷6 mm në ditë. Në vijim në figurën Nr. 3 paraqiten të dhënat e reshjeve dhe avullimit të vlerësuar sipas metodës “Penman Monteith” për vendmatjen e Lushnjës, ku dukshëm evidentohet fakti i deficitit hidrik të krijuar në veçanti në muajin korrik midis reshjeve mujore të rëna, të nivelit 20-30 mm dhe avullimit që shënon vlera mujore mbi 180 mm.




Figura Nr. 3 – Vlerat e reshjeve mujore dhe avullimit për vendmatjen meteorologjike të Lushnjës, sipas normës.

Temperaturat e ajrit. - Natyrisht në vitet e fundit, me rritjen e vlerave të temperaturave të ajrit si dhe me vërtetimin gjithnjë në rritje të dukurisë së pakësimit të reshjeve, treguesit e ETP dhe ETR kanë shënuar rritje, duke përcjellë një situatë mjaft më të vështirë për mbijetesën e bimësisë në tërësi e në veçanti të bimëve të kultivuara; duke bërë të domosdoshme pasjen e një sistemi ujitje në gatishmëri për të plotësuar nevojat e bimëve, që përkon dhe me fazat përmbyllëse të ciklit të tyre jetësor, ku varet në një shkallë të rëndësishme dhe prodhimi përfundimtar. Në figurën Nr. 4 jepet një paraqitje grafike e të dhënave të temperaturës mesatare të ajrit për muajin korrik 2017 për Tiranën, që rezulton me një rritje prej +2.2°C kundrejt normës si dhe vlerat e viteve të fundit 2012-2016 dhe ato të normës (që i referohen periudhës 1961-1990).

Figura Nr. 4 – Temperatura mesatare e ajrit për muajin korrik për vendmatjen meteorologjike të Tiranës.





Figura Nr. 5 – Temperaturat mesatare të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të vendit tonë për muajin korrik 2017.

Në perceptimin e përditshëm muaji korrik i këtij viti u konsiderua mjaft i nxehtë dhe me temperatura të larta. Gjithsesi për të patur një vlerësim shkencor në vijim jepen rezultat e të dhënave të përpunuara për disa stacione meteorologjike, të përzgjedhura dhe përfaqësuese për gjithë territorin e vendit tonë. Në se në tërësi temperaturat mesatare të ajrit, të cilat grafikisht paraqiten në figurën Nr. 5 vlerësohen të jenë $+2^{\circ}\text{C}$ deri $+3^{\circ}\text{C}$ më të larta se periudha e normës klimatike, që i referohet viteve 1961-1990, praktikisht me një analizë të mëtejshme dhe më të detajuar vihet re se ka një ndryshim të rëndësishëm sa i takon niveleve të arritura nga temperaturat maksimale dhe ato minimale.




Figura Nr. 6 – Vlerat mesatare të temperaturave maksimale të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të vendit tonë për muajin korrik 2017.

Të dhënat e vlerave mesatare të temperaturave maksimale të ajrit shënojnë një rritje më të lartë me afro $+3.5^{\circ}\text{C}$, që pasqyrohen dhe në figurën Nr. 6; ndërkohë që vlerat mesatare të temperaturave minimale të ajrit kanë një rritje më të moderuar prej afro $+1.9^{\circ}\text{C}$, paraqitur në figurën Nr. 7 në vijim.




Figura Nr. 7 – Vlerat mesatare të temperaturave minimale të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të vendit tonë për muajin korrik 2017.

Gjithashtu u analizua dhe numri i ditëve të nxehta me temperaturë maksimale të ajrit mbi pragu 35.0°C , i cili dëshmoi se dhe muaji korrik 2017 vijoi të ruajë vlera të larta të këtij treguesi në krahasim jo vetëm me normën, por dhe sa i takon viteve të fundit.




Figura Nr. 8 – Numri i ditëve me temperaturë maksimale të ajrit mbi pragu 35.0°C për vendmatjen meteorologjike të Tiranës.

Për të ilustruar më tej situatën meteorologjike të muajit korrik në vijim në figurën Nr. 9 jepen të dhënat e vlerave maksimale absolute të temperaturës së ajrit të vërtetuar në disa vendmatje meteorologjike në Shqipëri për muajin korrik 2017.




Figura Nr. 9 – Vlerat e temperaturave maksimale absolute të ajrit për disa vendmatje meteorologjike për muajin korrik 2017.

Një karakteristikë e veçantë që del në pah në vitet e fundit në klimën e vendit tonë janë ndryshimet që vërehen në treguesin e netëve tropikale, të cilat kanë shënuar rritje përkundrejt vlerave të normës.

Numri i netëve tropikale për vendmatjen meteorologjike të Tiranës shënoi gjatë muajit korrik 2017 vlera sa trefishi i normës. Të dhëna më të detajuara për ecurinë e netëve tropikale për periudhën e normës si dhe për periudhën 2002-2017 jepen në figurën Nr. 10.




Figura Nr. 10 – Numri i netëve tropikale për vendmatjen meteorologjike të Tiranës.

Në figurën Nr.11 jepet një informacion për netët tropikale për disa vendmatje meteorologjike të territorit të vendit për muajin korrik 2017, ku në vitet e fundit ka filluar të evidentohet kjo dukuri, e cila konfirmon dhe një herë se si po ndryshon klima në vendin tonë gjatë viteve të fundit duke mbartur gjithnjë e më shumë elementë dhe karakteristika të klimës subtropikale.




Figura Nr. 11 – Numri i netëve tropikale për disa vendmatje meteorologjike të vendit tonë.

Reshjet atmosferike – në përgjithësi për muajt e verës janë më tepër të kushtëzuara dhe nga influenca dhe kushtet orografike, përkundrejt natyrisht atyre specifike që përcjellin masat ajrore dhe frontet atmosferike që kalojnë mbi territor. Kështu ato shpesh prekin sipërfaqe të kufizuara të territorit.

Në tërësinë e tyre gjatë këtij muaji reshjet nuk kaluan vlerat e normës për një numër të madh vendmatjesh, të analizuar e përpunuara për këtë buletin (gjithsejtë 40 stacione), të cilat paraqiten dhe në figurën Nr. 12. Sasia e reshjeve të vërtetuara arriti deri në masën 96% të vlerave të normës, ndonëse pati mjaft zona, kryesisht ato të Ulëtisë Perëndimore, ku reshjet munguan dhe u theksua më tej dukuria e thatësisë apo e zjarreve në pyje, që u favorizuan dhe nga temperaturat e larta siç u përmendën më sipër.




Figura Nr. 12 – Vlerat e reshjeve atmosferike për disa vendmatje meteorologjike për muajin korrik 2017.


Në zonat ku u vërtetuan reshje gjithsesi duhet thënë se ato kishin më shumë natyrë lokale dhe ishin në nivele të moderuara, gjë që tregohet dhe nga vlerat e reshjeve maksimale 24 orëshe, të cilat mesatarisht arrijnë në vlera 20 deri 50 mm. Këto sasi reshjesh në këtë periudhë kohore dhe për shkak të niveleve të larta të avullimit neutralizohen shpejt në kohë dhe hapësirë e nuk përbëjnë shkak për problematika. Reshjet maksimale 24 orëshe për muajin korrik 2017 për disa vendmatje meteorologjike paraqiten në figurën Nr. 13.



Figura Nr. 13 – Vlerat e reshjeve maksimale 24 orëshe për disa vendmatje meteorologjike për muajin korrik 2017.

Një tregues tjetër i rëndësishëm në vlerësimin e klimës është ai i numrit të ditëve me reshje mbi një prag të caktuar.


Numri i ditëve me reshje mbi pragu 1.0 mm shënoi vlera deri në 79% të normës duke konfirmuar dhe një herë uljen e këtij treguesi në vitet e fundit, sa i takon kësaj karakteristike klimatike për vendin tonë, referuar të dhënave të përpunuara për 40 vendmatje meteorologjike për muajin korrik 2017 dhe të paraqitura në figurën Nr.14.




VLERËSIME MBI SITUATËN METEOROLOGJIKE TË PRITSHME PËR MUAJT NË VIJIM.

TEMPERATURA E AJRIT - Në figurën Nr. 15 në vijim jepet situata e pritshme për temperaturat e ajrit për muajt nëntor, dhjetor 2017 dhe janar 2018. Vetëm pjesa veriore e vendit tonë rezulton që mund të jetë më e influencuar dhe e prekur nga vlera nën normë.

Parashikimi i probabiliteteve sipas modeleve të IRI-t, për temperaturën e ajrit për muajt: Nëntor – Dhjetor 2017 - Janar 2018




RESHJET ATMOSFERIKE – Reshjet e pritshme për muajt nëntor, dhjetor 2017 dhe janar 2018 në kontinentin European paraqiten me dy pamje; pjesa qendrore dhe perëndimore e kontinentit pritet të jetë me reshje të mundshme mbi normë, ndërsa pjesa e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe pjesa qendrore e gadishulli Apenin pritet të karakterizohet me reshje më të pakta me vlera nën normë. Në figurën në vijim jepet një pamje më e detajuar e situatës së pritshme të reshjeve në kontinentin European, ku edhe në këtë emetim të muajit gusht 2017 paraqitur në figurën Nr.16, situata e pritshme me reshje më të pakta dhe në hapësirën e vendit tonë ngelet e qëndrueshme, ashtu siç është evidentuar dhe në buletin Nr. 6 2017.



INFORMACIONE TË TJERA

Fatkeqësitë natyrore po provokohen gjithnjë e më shumë nga një atmosferë që lëviz më ngadalë.

Studiuesi Stefan Rahmstorf, i Institutit Klimatik të Posdamit ka paraqitur një hipotezë të re mbi arsyet e përkeqësimit të dukurive ekstreme dhe përmbajtjeve, të cilat po shtohen gjithnjë e më shumë në vitet e fundit. Kjo ka lidhje sipas kësaj hipoteze me atë që rrymat ajrore në lartësi (“jet stream”) janë ngadalësuar për shkak të rritjes së temperaturës globale. Për pasojë masat ajrore qëndrojnë për një kohë më të gjatë dhe lëvizim më ngadalë në tërësinë e atmosferës, gjë që reflektohet me një rritje të periudhave kohore me mot të ngjashëm. E njëjta gjë ndodh kur është fjala




dhe për situatat që përcjellin dukuri ekstreme. Në fakt, një situatë me presion të ulët atmosferik e “bllokuar” për shumë ditë mbi një zonë të caktuar përcjell nga ana e saj në atë hapësirë më shumë reshje, se sa në se ajo do të zhvendosej normalisht. Po ashtu sikundër ndodh, kur kemi një masë ajrore anticiklonare, “relativisht e ndaluar”, apo në lëvizje më të ngadaltë se normalisht, që qëndron për një kohë më të madhe mbi një hapësirë të caktuar; sigurisht ajo në këtë rast do të shoqërohet dhe përcjellë një situatë pa reshje, pra me thatësi, por më të zgjatur në kohë (*).

* Përkthyer e përshtatur për këtë buletin nga Prof. Petrit Zorba. “Science & Vie”, Nr.1197, Juin 2017.

Disa fakte nga vendi ynë. - Bazuar në disa analiza dhe studime mbi klimën në vendin tonë, pas një përpunimi shkencor të informacionit meteorologjik dhe klimatik rezultojnë disa përfundime interesante dhe me mjaft vlerë, të cilat në një formë konfirmojnë sa më sipër u përmend. Treguesi i numrit të ditëve me reshje mbi pragun ($\geq 10.0\text{mm}$ apo $\geq 30.0\text{mm}$) dëshmon për një tendencë në rritje të vlerave, ndonëse në tërësinë e tyre vjetore si sasia e reshjeve ashtu dhe numri i ditëve me reshje mbi pragun ($\geq 0.1\text{ mm}$) pasqyrojnë një ulje në këto vitet e fundit.

Kjo evidentohet dhe në tendencën e të dhënave për vendmatjen meteorologjike të Fierit paraqitur në figurën Nr. 17, Kukësit, etj.

Figura 17. Numri i ditëve me reshje mbi pragun 10.0mm për vendmatjen meteorologjike të Fierit.



Po ashtu thatësira e këtij viti është një tregues tjetër që në dhjetëvjeçarin e fundit ka njohur rritje. Në veçanti duhet evidentuar mungesa totale e reshjeve në muajin dhjetor 2015, apo vetëm pak mm (nën 10mm gjithsejtë) po ashtu në dhjetor 2016, ndërkohë që muaji dhjetor nga pikëpamja klimatike konsiderohet për klimën e vendin tonë si një nga muajt me më shumë reshje.

Për të lexuar buletinet e tjera jeni të mirëpritur të vizitoni faqen përkatëse, duke klikuar në link-un e IGJEUM-it.



<http://www.geo.edu.al>



☀ ☀ ☀
Ky “Buletin Mujor Klimatik” u përgatit nga
Departamenti i Klimës dhe Mjedisit të
IGJEUM-UPT.
Tiranë © 2017.

